

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPSTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 9/113 Nr. i faq./Br. str./No. pg 85

Data/Datum/Date 20/02/2026

1



RAPORT I KUVENDIT KOMUNAL TË RAHOVECIT (JANAR- DHJETOR 2025)

SHKURT 2026

2025

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
QËLLIMI I RAPORTIT	3
FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT	3
KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS	4
KOMITETI PËR KOMUNITETE	5
KOMITETET KONSULTATIVE.....	5
MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE.....	6
VENDIMET E KUVENDIT PËR VITIN 2025.....	8-13
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA	14-15
KOMITETI PËR KOMUNITETE.....	16-17
KOMITETI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE.....	7-18
KOMITETI KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	18-19
KËSHILLI KOMUNSL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2024.....	19-20
DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2025	20-21
INFORMIMI RRETH MBAJTJES SË DËGJIMEVE BUXHETORE.....	21-22
MONITORIMI I MBLEDHJEVE.....	22
RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS.....	22
NJOFTIMET PËR MBLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLËSE.....	23
PUBLIKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN TË KOMUNËS SË RAHOVECIT.....	24
SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE.....	25
PËRFUNDIM.....	25

HYRJE

Të nderuar Kuvendar/e të Komunës të Kuvendit Komunal të Rahovecit,

Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin dymbëdhjetë mujor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit përgjatë periudhës janar- dhjetor 2025.

Në sistemin e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, komuna është njësia themelore e vetëqeverisjes me ç 'rast i gjithë territori i Kosovës është i ndarë në 38 komuna.

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë organet kryesore të komunës dhe që të dyja zgjedhën veç e veç dhe me vota të drejtpërdrejta të qytetarëve të komunës, të cilat janë obliguara të ushtrojnë kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparente dhe llogaridhënien e organeve të komunës si dhe garanton një kontroll të ndërsjellë ndërmjet organeve komunale.

Në kuadër të organeve të Komunës së Rahovecit, Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Planin e Punës së Kuvendit të Komunës.

QËLLIMI I RAPORTIT

Përmes këtij raporti jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre. Ky raport ka për qëllim që të rrit transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Kuvendi i Komunës së Rahovecit është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, dhe Planit të Punës së Kuvendit të Komunës. Kuvendi duhet të mbaj së paku 10 mbledhje në vit, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit dhe 5 (pesë) në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

KOMITETET OBLIGATIVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës ka komitetet obligative sic janë:

- Komiteti për Politikë dhe Financa,
- Komiteti për Komunitete

KOMITETET TJERA TË KUVENDIT

- Komitetet ndihmëse të cilat kanë për qëllim shqyrtimin e hollësishëm të politikëve, dokumenteve strategjike, vendimeve dhe rregulloreve të komunës nga njëra anë, si dhe mbikqyrjen e veprimtarive të degës ekzekutive në anën tjetër.

Andaj, Kuvendi i Komunës, themelon komitete tjera, të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre kompetencave.

Komitetet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit

- Komiteti për Arsim (Komitete tjera o jo obligative)
- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (Komitete tjera – jo obligative)
- Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuar (Komitete Konsultative)
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (i përhershëm)

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Komiteti për Politikë dhe Financa është organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Kështu, Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

- Të gjitha politikëve,
- Dokumenteve fiskale dhe financiare,
- Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,
- Kornizës vjetore buxhetore afatmesme,
- Planit vjetor të prokurimit,
- Rregullores vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat,
- Planit vjetor të punës për auditimin e brendshëm,

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

- Planit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe
- Marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal.

Komiteti për Politikë dhe Financa, gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur një performancë të mirë duke e përmbushur obligimin e tij ligjor, që të mbajë takimet e rregullta, por edhe të trajtojë të gjitha dokumentet e rëndësishme para se ato të kalojnë për diskutim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 10 (dhjetë) mbledhje për periudhën: **janar –dhjetor**, për shkak që ka qene viti zgjedhor. Gjatë këtyre seancave ka diskutuar pika të ndryshme duke qenë në kompetencë të saj, ajo ka diskutuar dhe ka rekomanduar Kuvendit për të gjitha çështjet që i ka pasur në rend të ditës.

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Komiteti për Komunitete është komiteti i dytë obligativ i Kuvendit të Komunës, detyrë e të cilit është:

- Shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim.
- Shqyrtimi i të gjitha politikëve komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- I rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komiteti për Komunitete si komitet i përhershëm në këtë dymbëdhjetë mujor ka vepruar në mënyrë të rregullt dhe në përbërje të plotë, dhe gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsej shtetë (5) mbledhje të rregullta.

KOMITETET E TJERA OSE KONSULTATIVE

Komitetet e Tjera ose Konsultative - Kuvendi i Komunës themelon komitete të tjera ose konsultative për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësieve të tyre. Në Komunën tonë është janë themeluar Komiteti për Arsim dhe Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Po ashtu në Komunën tonë nga ana e kryetarit është i themeluar edhe i Komiteti për Auditim të Brendshëm.

Komiteti për Arsim ka mbajtur vetëm nj (1),takim.

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, ka mbajtur katër (4), takime dhe

Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuar ka mbajtur katër (4) takime.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar rregullat e mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku dhjetë (10) mbledhje në vit të Kuvendit të Komunës, ku pesë mbledhje duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë dhe pesë mbledhje në gjashtëmujorin e dytë.

Bazuar në këtë, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 43.2 të LVL-ës, ku në periudhën janar- dhjetor 2025 ka mbajtur:

- **10 (dhjetë) mbledhje të rregullta;**
- **1 (një) mbledhje solemne;**
- **1 (një) mbledhja Urgjente;**
- **1 (një) mbledhja Inaguruese.**

141 Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, komitetet shqyrtojnë agjendën nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim-akteve. Vlen të theksohet se në 10 (dhjet) mbledhjet e Kuvendit Komunal në Rahovec për vitin 2025, ka qenë prezent, Kryetari i Komunës së Rahovecit dhe drejtorët.

MBLEDHJET E KUVENDIT

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë e punimeve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe komiteteve, për periudhën një veçare. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe lloji i mbledhjeve për periudhën janar-dhjetor 2025.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Seancat e Kuvendit Komunal	Seanca të rregullta	Seancë Urgjente	Seanca tjera(solemne, komomorative)	Mbledhja Inaguruese	Nr. i seancave për muaj	Pika në rend dite
Janar	1				1	19
Shkurt	1		1		2	8
Mars	1				1	15
Prill	1				1	16
Maj	1				1	8
Qershor	1		1		2	11
Korrik	1				1	10
Gusht	1				1	8
Shtator	1	1			2	5
Tetor						
Nëntor	1				1	3
Dhjetor	1			1	2	5
Gjithsesj:	11	1	2	15	15	108 pika të rendit të ditës

VENDIMET E KUVENDIT PËR VITIN 2025

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjet e mbajtura në vitin 2025 i ka aprovuar gjithsej 50 (pesëdhjet) vendime, 2 (dy) Rregullore, 17 (shtatëmbëdhjet) Raporte dhe 14 (katërmëdhjet) informata.

Në tabalqaret e mëposhtme i keni të cekur të gjitha Statutet, rregulloret, vendimet, planet, raportet dhe Informatat që janë aprovuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025.

	Emërtimi i Vendimit	Datat e aprovimit
1	VENDIM I KUVENDIT - Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës ZK Rahovec	31.05.2025
2	VENDIM I KUVENDIT - Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës ZK Xërxë	31.05.2025
3	VENDIM I KUVENDIT - për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme për rastet e veçanta - Ministria e Ekonomisë	31.05.2025
4	VENDIM I KUVENDIT - për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Rahovec - Bujqësi	31.05.2025
5	VENDIM I KUVENDIT - për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Xërxë - Bujqësi	31.05.2025
6	VENDIM I KUVENDIT - për formimin e komisionit përzgjedhës për Komitetit konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara	31.05.2025
7	VENDIM I KUVENDIT - për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 2025	31.05.2025
8	VENDIM I KUVENDIT - për miratimin e planit të punës të Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe 2025	31.05.2025
9	Vendim për miratimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025	31.05.2025
10	VENDIM I KUVENDIT - Për vënien nën mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë si Monument Natyror - 2025	28.02.2025
11	VENDIM I KUVENDIT - Plotësimi dhe ndryshimi i vendimit për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara	28.02.2025
12	VENDIM I KUVENDIT - Plotësimi dhe ndryshimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë - Maja e Shkodranit	28.02.2025

13	VENDIM I KUVENDIT-Për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike ne Rahovec	28.02.2025
14	VENDIM I KUVENDIT - Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së komunës - Park Hotel Plaza	28.03.2025
15	VENDIM I KUVENDIT - Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së komunës në ZK Rahovec për biznese	28.03.2025
16	VENDIM I KUVENDIT - Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës -Radostë	28.03.2025
17	VENDIM I KUVENDIT - Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 dhe 2024 në vitin 2025	28.03.2025
18	VENDIM I KUVENDIT - Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)	28.03.2025
19	VENDIM I KUVENDIT - për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në ZK Rahovec për biznese	28.03.2025
20	VENDIM I KUVENDIT - për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale Park Hotel Plaza	28.03.2025
21	VENDIM I KUVENDIT - për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Radoste- Bujqesi	28.03.2025
22	VENDIM I KUVENDIT - për miratimin e Raportit të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	28.03.2025
23	VENDIM I KUVENDIT - për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc	28.03.2025
24	Vendim i Kuvendit - Shpalljen me interesi të përgjithshëm publik të parcelës P-71510057-00095-6 në Zonën Kadastrale Rahovec	28.03.2025
25	Vendim i komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së komunës P-71510069-01496-0 - Retijë	29.04.2025
26	VENDIM I KUVENDIT - Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës -RAHOVEC	29.04.2025
27	Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave - 2025	29.04.2025

28	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).	29.04.2025
29	Vendim për dhënien e të drejtës së kalimit - të drejtës së servitutit sendor në Rahovec	29.04.2025
30	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale P-71510069-01496-0 - Retijë	29.04.2025
31	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Rahovec- Bujqesi	29.04.2025
32	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 32-25 i datës 28.03.2025 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies së pronës	29.04.2025
33	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 3125 i datës 28.03.2025 për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës	29.04.2025
34	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesë së parcelës në Rahovec-Rruga Halil Hamza-P-08994-0 ZK-Rahovec	29.04.2025
35	Vendimi për shfuqizimin të vendimit Nr. Prot. 01 Nr. 21-25 i datës 28.02.2025 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike.	29.04.2025
36	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për turizëm dhe rekreacion	30.05.2025
37	Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01022-0 ZK-Hoçë e Madhe	30.05.2025
38	Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01830-0 ZK-Rahovec- Respektivisht lokali te parku i qytetit	30.05.2025
39	Vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01022-0 ZK-Hoçë e Madhe	30.05.2025
40	Vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01830-0 ZK-Rahovec- Respektivisht lokali te parku i qytetit	30.05.2025
41	Vendimi për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.4625 të datës 29.04.2025, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për rastet e veçanta	30.05.2025
42	VENDIM I KUVENDIT - për dhënien e të drejtës së kalimit - të drejtës së servitutit sendor në Rahovec	60.06.2025

43	VENDIM I KUVENDIT - Për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore (KAB) 2026-2028	60.06.2025
44	VENDIM I KUVENDIT - Për miratimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025 - 2028	60.06.2025
45	VENDIM I KUVENDIT - për shfuqizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV	60.06.2025
46	VENDIM i Kuvendit për emërtimin e Qendrës për Kulturë Arte dhe Inovacion me emrin e heroit Abdullah Bugari	60.06.2025
47	Vendim për dhurimin e llaptopave anëtarëve të Kuvendit të Komunës	29.08.2025
48	Vendim për miratimin e Deklaratës për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike	29.08.2025
49	VENDIM I KUVENDIT - për miratimin e buxhetit për vitin 2026	29.09.2025
50	VENDIM I KUVENDIT - për Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit	08.12.2025

Tabelari me Raportet e diskutuara në mbledhje të kuvendit gjatë vitit 2025

1	Shqyrtimi i raportit vjetor financiar janar – dhjetor 2024	30.01.2025
2	Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023	30.01.2025
3	Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024	30.01.2025
4	Shqyrtimi i raportit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024	30.01.2025
5	Shqyrtimi i raporti vjetor rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024	30.01.2025
6	Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2024	30.01.2025
7	Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2024	30.01.2025
8	Shqyrtimi i raportit rreth fatkeqësive natyrore për vitin 2024	28.03.2025
9	Shqyrtimi i raportit financiar, janar – mars 2025	29.04.2025

10	Shqyrtimi i raportit 6 mujore, janar – qershor 2025 i kryetarit të komunës	30.06.2025
11	Shqyrtimi i Raportit 6 mujor i punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2025	24.07.2025
12	Shqyrtimi i Raportit të DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor 2024-2025	24.07.2025
13	Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar – qershor 2025	24.07.2025
14	Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2024	24.07.2025
15	Shqyrtimi i raportit për zbatimin e Planit të Integritetit, janar – qershor 2025	29.08.2025
16	Shqyrtimi i Raportit financiar janar – shtator 2025	05.11.2025
17	Shqyrtimi i raportit vjetor të performances komunale për vitin 2024	05.11.2025

Tabelari me Informatat e diskutuara në mbledhje të kuvendit gjatë vitit 2025

1	Shqyrtimi i informatës rreth punës së KKSB-së për vitin 2024	31.01.2025
2	Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre;	28.03.2025
3	Shqyrtimi i informatës rreth menaxhimit të aseteve komunale;	28.03.2025
4	Shqyrtimi i informatës rreth hotel “Park plaza”, Rahovec;	28.03.2025
5	Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në komunën e Rahovecit, për vitin 2024-2025	29.04.2025
6	Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKSB-së për 6 mujorin e parë të vitit 2025	30.06.2025
7	Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, për 6 mujorin e parë të vitit 2025	30.06.2025
8	Shqyrtimi i informatës për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovecit, për 6-mujorin e parë të vitit 2025.	30.06.2025
9	Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – qershor 2025;	24.07.2025

10	Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, janar – qershor 2025;	24.07.2025
11	Shqyrtimi i informatës për furnizim me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve në komunën e Rahovecit	24.07.2025
12	Shqyrtimi i informatës për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovecit;	29.08.2025
13	Shqyrtimi i informatës rreth aktiviteteve për nder të Muajit të mërgimtarëve për vitin 2025	29.08.2025
14	Shqyrtimi i informatës për përgatitjen e vitit shkollor 2025/2026.	22.09.2025

Në vijim të raportit do të gjeni edhe fotografi të realizuara gjatë mbajtjes së Kuvendit të Komunës;



KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC



Komitetet e Përhershme të themeluara nga Kuvendit i Komunës së Rahovecit

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Komiteti për Politik dhe Financa është themeluar me datë 25.01.202, sipas ligjit për vetqeverisje lokale 03/L-040, Udhëzimit administrativ Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera dhe Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 .

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej dhjetë (10) mbledhje për periudhën: janar – dhjetor 2024.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Komitetin për Politikë dhe Financa të Komunës së Rahovecit për periudhën janar - dhjetor të vitit 2025. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe numri i pikave të rednit të ditës për periudhën janar- dhjetor 2025.

Komiteti Politikë Financa	për dhe	Mbledhje rregullta	të	Nr.i mbledhjeve për muaj	Pika në rend dite
Janar		1		1	1
Shkurt		1		1	5
Mars		1		1	10
Prill		1		1	10
Maj		1		1	6
Qershor		1		1	5
Korrik		1		1	8

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Gusht	1	1	5
Shtator	1	1	3
Tetor			
Nëntor	1	1	3
Dhjetor			
Gjithsesj:	12	12	56 pika të rendit të ditës

Në vijim të raportit do të gjeni Fotografî të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Komiteti për Komunitete është themeluar me datë 25.01.202, sipas ligjit për vetqeverisje lokale 03/L-040, Udhëzimit administrativ Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përpërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera dhe Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej pesë (5) mbledhje për periudhën: janar – dhjetor 2025.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Komitetin Komunitete të Komunës së Rahovecit për periudhën janar - dhjetor të vitit 2025. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe numri i pikave të rednit të ditës për periudhën janar- dhjetor 2025.

Komiteti për Komunitete	Mbledhje rregullta	Nr.i mbledhjeve për muaj	Pika në rend dite
Janar	1	1	4
Mars	1	1	4
Korrik	1	1	3
Gusht	1	1	4
Nëntor	1	1	3
Gjithsesj:	11	11	18 pika të rendit të ditës

Në vijim të raportit do të gjeni Fotografi të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Komunitete.



KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC



KOMITETI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është themeluar me datë 31.05.2022, sipas ligjit për vetqeverisje lokale 03/L-040, Udhëzimit administrativ Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera dhe Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017. Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje për periudhën: janar – dhjetor 2025.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Komitetin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të Komunës së Rahovecit për periudhën janar - dhjetor të vitit 2025. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe numri i pikave të rendit të ditës për periudhën janar- dhjetor 2025.

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	Mbledhje të rregullta	Nr.i mbledhjeve për muaj	Pika në rend dite
Shkurt	1	1	3
Maj	1	1	5
Korrik	1	1	5
Gusht	1	1	3
Gjithsesj:	11	11	16 pika të rendit të ditës

Në vijim të raportit do të gjeni Fotografë të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC



KOMITETI KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit, është themeluar me datë 30.01.2024, sipas ligjit për vetqeverisje lokale 03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna dhe Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017.

Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuara ka mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje për periudhën: janar – dhjetor 2025.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Komitetin për Personat me Aftësi të Kufizuara të Komunës së Rahovecit për periudhën janar - dhjetor të vitit 2025. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe numri i pikave të rendit të ditës për periudhën janar- dhjetor 2025.

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara	Mbledhje të rregullta	Nr.i mbledhjeve për muaj	Pika në rend dite
Mars	1	1	4
Prill	1	1	3
Maj	1	1	3
Qershor	1	1	3
Gjithsesj:	11	11	13 pika të rendit të ditës

Në vijim të raportit do të gjeni Fotografi të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara.



KËSHILLI KOMUNSL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2025

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Rahovecit. është themeluar me datë 25.01.2022, sipas ligjit për vetqeverisje lokale 03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2012 për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, Nr.27/2012 (MPB) për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi në Komuna dhe Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjithsej pesë (5) mbledhje për periudhën: janar – dhjetor 2025. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Rahovecit për periudhën janar - dhjetor të vitit 2025. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe numri i pikave të rendit të ditës për periudhën janar- dhjetor 2025.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi	Mbledhje të rregullta	Nr.i mbledhjeve për muaj	Pika në rend dite
janar	1	1	11
Mars	1	1	8
Qershor	1	1	8
Gusht	1	1	8
Shtator	1	1	7
Gjithsesj:	8	8	42 pika të rendit të ditës

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Në vijim të raportit do të gjeni Fotografitë të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.



DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2026

Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen konsultime publike. Arsyeja pse është përzgjedhur ky zotim është që të fuqizohet qeverisja e mirë, bazë e së cilës është pjesëmarrja qytetare në draftim të politikëve lokale përfshirë buxhetin, për një qeverisje gjithëpërfshirëse.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimi të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e shihet të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të

informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore, dhe detajon procedurat për mbarrëvajtjen e tyre.

Në bazë të nenit 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 61 paragrafi 2 Të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, neni 17, 18 pika 1.7 dhe 19 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizonë minimumi 1 dëgjim publik rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025.

INFORMIMI RRETH MBAJTJES SË DËGJIMEVE BUXHETORE

Një nga sfidat kryesore të dëgjimeve buxhetore është mënyra e informimit të qytetarëve. UA për transparencë i obligon komunat që paralajmërimin e publikut për mbajtje të takimeve publike ta bëjnë përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës 14 ditë para mbajtjes së dëgjimit. Komuna e Rahovecit ka bërë njoftimin për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 14 ditë para mbajtjes së takimeve përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës. Njoftimi ka përfshirë informata si data, koha dhe vendi i takimit, KPF-ja e ka mbajtur 1 (një) dëgjim mpublik.

Dëgjimet publike publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2026, janë përcjellur edhe nga Zyra e Kuvendit Komunal Rahovec, si dhe Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, ku pas mbajtjes së dëgjimit publik në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit, janë publikuar të dhënat e mbajtjes së dëgjimeve me fotografi dhe të dhëna tjera të nevojshme.

Gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2026 Komiteti për Politikë dhe Financa i kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Arber Zenuni, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani kanë përcjellur vazhdimisht ecurinë e dëgjimeve publike me qytetarë të Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2026, Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht pothuajse të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, posaçërisht, dhe Kuvendi i Komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si buxheti komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit dhe i jep rekomandimet për veprime Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës duke marrë parasysh edhe rekomandimet nga komiteti për politikë dhe financa, do të shqyrtojë, dhe në rast pajtimi, të miratojë, dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Kryesuesi i KK-Rahovec z.Arber Zenuni, pasuar më pas nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani i cili në secilin dëgjim të mbajtur ofroi informacionet e nevojshme lidhur me ndarjen e kategorive të buxhetit në ; Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale, Subvencione e transfere dhe Investime Kapitale, të pranishmit në secilin dëgjim publik të mbajtur patën mundësi të informoheshin nga drejtori i DBF-së edhe për totalin e buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2026 e që në tërësi është: **21,547,734.00 €**, Buxheti i Komunës së Rahovecit është aprovuar në mbledhjen e dates 29.09.2025.

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve edhe gjatë këtij viti ka qenë i vazhdueshëm, puna dhe angazhimi ynë është monitoruar nga OSBE-ja, KFOR-i, OJQ-të lokale si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën, aktivitetet dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve tona. Gjithashtu, mbledhjet e Kuvendit Komunal Rahovec, janë regjistruar (xhiruar) rregullisht dhe janë transmetuar online për qytetarët e Komunës së Rahovecit.

RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Sistemi i qeverisjes lokale është një njësi e gjerë e cila përfshin edhe bashkëpunimin në mes të Ekzekutivit të komunës dhe Kuvendit me qëllim të realizimit të politikëve publike në dobi të qytetarëve. Për këtë qëllim, mbikëqyrja dhe raportimi përbëjnë një proces mjaft të rëndësishëm të qeverisjes lokale, përmes të cilit mundësohet përcjellja sistematike e ngjarjeve dhe aktiviteteve brenda komunës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Rahovecit i paraqet me shkrim raportet në Kuvendin e Komunës. Formë tjetër e raportimit është edhe ajo verbale, ku anëtarët e Kuvendit parashtrojnë pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim, varësisht nga natyra e çështjes. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së Ekzekutivit para Kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje.

Kryetari i Komunës i ka raportuar 2 herë brenda viti 2025 Kuvendi të Komunës, rreth raportit të punës së tijë 1 vjeqare. Raportimi i parë ka qenë në mbledhjen e mbajtur me datën 30.06.2025, kurse raportimi i dytë me datën 26.01.2026

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLËSE

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës, Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, Rregullores së Punës së Kuvendit për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, edhe për mbledhjet e të gjitha komiteteve të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit janë njoftuar me kohë, shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, përmes shpalljes së njoftimeve publike në vendet e frekuentuara, si dhe përmes faqes zyrtare të komunës në internet.

Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes është respektuar Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Njoftimet dhe materialet gjithashtu u janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit Lokal (MAPL) konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

PUBLIKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në faqen elektronike të Komunës së Rahovecit.

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

Ministria e Pushtetit Lokal është autoritet mbikqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve, andaj gjatë periudhës janar - dhjetor 2025 nga zyra e kuvendit për shqyrtimin e ligjshmërisë janë dërguar Ministrisë së Pushtetit Lokal gjithsej 51 akte që janë marr nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit. Numri i Konfirmimit të ligjshmërisë së vendimeve të kthyer nga MAPL-ja është gjithsej 30.

Nga 30 (tridhjet) konfirmime, 3 (tre) vendime janë rishqyrtuar duke u bazuar në rekomandimet e dhëna nga MAPL-ja.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet aktivitetet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese janar – dhjetor 2025. Raporti i punës i Kuvendit Komunal- Rahovec, është dëshmi e respektimit të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në frymën e transparencës, llogaridhënies dhe performances sa më të mirë komunale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale që mundet ti ketë ky raport, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.


Ju faleminderit!

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/26


Me datë: 00.02.2026

Skender Hamza



Udhëheqës i Zyrës për Punë të Kuvendit

Fatmir Iska



Kryesuesi i Kuvendit

